**Decision No. 01/19, dated 30/03/2020 ("Decision"), approved by the Government of Republic of Kosovo, has enacted the Emergency Fiscal Package, with purpose of financial support for the business organizations, employees and individuals that are facing financial difficulties due to the public health emergency as consequence of Virus COVID - 19**

With purpose of assisting the business organizations that are facing financial difficulties due to the situation of public health emergency, the Government of Kosovo through the present decision has enacted the Emergency Fiscal Package in general amount of 179,6 million EUR, which envisages following measures:

- Double payment of the social assistance scheme to all beneficiaries of social assistance schemes for April and May, a measure amounting to seven million six hundred fifty thousand (€7,650,000.00) Euros, including payments executed for March;
- Payment of an additional sum of thirty (€30) Euros per month to all beneficiaries of social assistance and pension schemes who receive a monthly payment lower than one-hundred (€100) Euros, for April, May and June, provided that they are beneficiaries of only one scheme; and reinstatement into the list of beneficiaries of all persons who, as a result of the failure to appear or lack of assessment for the period January-March 2020, have not had their entitlements renewed. This measure amounts to thirteen million (€13,000,000.00) Euros;
- Financial support for business organisation under financial distress due to the downfall of their business activity that resulted from the public health emergency situation, as follows:
  - i. Covering of expenditures for the monthly salaries in the amount of one hundred seventy (€170) Euros for April and May, a measure amounting to forty-one million (€41,000,000.00) Euros;
  - ii. Rent subsidy up to fifty percent (50%) of the rent value for small and medium enterprises for April and May, a measure amounting to twelve million (€12,000,000.00) Euros; and
  - iii. Covering of the value of pension contributions with regard to the measures foreseen under this Decision for April and May, amounting to eight million (€8,000,000.00) Euros;

- Provision of interest-free loans to publicly-owned enterprises facing financial difficulties due to the public health emergency situation, aiming to ensure their temporary liquidity, with maturity period until 31.12.2020, amounting up to twenty million (€20,000,000.00) Euros;
- Provision of additional financial support for Municipalities of the Republic of Kosovo affected by the pandemic, if so required due to the eventual extension of the public health emergency situation, amounting up to ten million (€10,000,000.00) Euros;
- Provision of a salary top-up in the amount of three hundred (€300) Euros for field workers and those exposed directly to the risk of infection in their work (not the entire staff of the institution): medical staff (doctors and nurses), members of Kosovo Police, officials (guardians) of the Correctional Services, officials (fire-fighters) of the Emergency Management Agency, KSF (soldiers) personnel, employees working at the Quarantine – Student Centre in Prishtina, officials (inspectors) of the Labour Inspectorate, officials (inspectors) of the Tax Administration of Kosovo, officials of the Kosovo Customs, officials (inspectors) of the Market Inspectorate, officials (inspectors) of respective municipal inspectorates, officials (inspectors) of Labour Medicine, for April and May, amounting up to fifteen million (€15,000,000.00) Euros;
- Additional payment in the amount of one hundred (€100) Euros to employees of grocery stores, bakeries and pharmacies for April and May, amounting up to three million (€3,000,000.00) Euros;
- Payment of monthly assistance in the amount of one hundred and thirty (€130) Euros to citizens who lose their jobs due to the public health emergency situation, for April, May and June, amounting up to four million (€4,000,000.00) Euros;
- Support to initiatives and projects aimed at improving the lives of non-majority communities in the Republic of Kosovo that have been hit hardest by the public health emergency situation, amounting up to two million (€2,000,000.00) Euros;
- Provision of financial liquidity for:
    i. Micro-enterprises and the self-employed through certain programs of the Kosovo Credit Guarantee Fund, in the amount of ten thousand (€10,000) Euros for a period of 24 months, amounting up to fifteen million (€15,000,000.00) Euros; and

ii. Business Organizations/Companies authorized to provide basic services (similar to those of Publicly-Owned Enterprises) on return by 31.12.2020, within the value specified in 1.4 of this Decision.

- Increase of budget for grants and subsidies to the Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development in order to increase agricultural production, amounting to five million (€5,000,000.00) Euros;
- Increase of budget for grants and subsidies to the Ministry of Culture, Youth and Sports in order to avoid the situation created by the public health emergency in sports and cultural activities, amounting to five million (€5,000,000.00) Euros;
- Support to exporters in the Republic of Kosovo after the public health emergency situation ends, amounting to ten million (€10,000,000.00) Euros;
- Financial support to business organizations registering employees with at least one (1) year employment contract during the period of public health emergency situation, with one hundred and thirty (€130) Euros for the following two months after registration, amounting up to six million (€6,000,000.00) Euros; and
- Payment of monthly assistance in the amount of one hundred and thirty (€130) Euros to citizens living under poor social conditions, declared as unemployed in the competent institution and who are not beneficiaries of any monthly income from the Kosovo budget, for April, May and June, amounting up to three million (€3,000,000.00) Euros;

The Minister of Finance and Transfers is authorized to render the decision which envisages the necessary measures for implementation of the Emergency Fiscal Package, namely terms, criteria, method of implementation and other specifications, based on the principles of management of public finances.

This document is delivered for informative purposes only. It does not constitute legal/tax counsel and/or commitments of any nature. For any further clarification please contact:
**tax_legal-alko@deloittece.com**

**Vendimi nr. 01/19, i datës 30/03/2020 ("Vendimi"), i miratuar nga e Qeveria e Republikës së Kosovës, ka aprovuar Pakon Emergjente Fiskale. me qëllim të mbështetjes financiare për shoqëritë tregtare, puëntorët dhe individëve, të cilët gjenden në vështirësi si pasojë e situatës së emergjencës së shëndetit publik si pasojë e COVID-19**

Me qëllimin për të lehtësuar operatorët ekonomik të cilët janë duke hasur probleme financiare për shkak të situatës së emergjencës publike shëndetësore, Qeveria e Republikës së Kosovës përmes këtij Vendimi, ka aprovuar Pakon Emergjente Fiskale në vlerë të përgjithshme prej 179,6 milion euro, me të cilën parashihen masat si në vijim:

- Pagesa e dyfisht e vlerës së skemës sociale për të gjithë përfituesit e skemave sociale për muajt prill dhe maj, me vlerën e 7.650.000.00 EUR (shtatë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë euro) përfshihet këtu pagesa e muajit mars.
- Pagesa shtesë në vlerë prej 30 EUR (tridhjetë eurosh) në muajt për të gjithë përfituesit e skemave sociale dhe pensionale që marrin pagesë mujore në vlerë më të ulët se 100 EUR (njëqind euro), për muajt prill, maj dhe qershor, me kusht që janë përfitues të vetëm një skeme; si dhe rikthim në listat e përfituesve për përfituesit që për shkak të mos-paraqitjes apo mos-vlerësimit në periudhën janar-mars 2020, nuk u janë rinovuar të drejtat e tyre. Kjo masë është në vlerë deri në 13.000.000.00 EUR (trembëdhjetë milion euro).
- Mbështetja financiare për shoqëritë tregtare në vështirësi financiare si pasojë e rënies së veprimtarisë së tyre për shkak të emergjencës së shëndetit publik, do të bëhet si në vijim:

  i. Mbulimi i shpenzimeve të pagave mujore të punonjësve në vlerë prej 170 EUR (njëqind e shtatëdhjetë euro) për muajt prill dhe maj. Për këtë masë janë të ndara 41.000.000.00 EUR (dyzet e një milion euro).
  ii. Subvencionimi i qirasë deri në 50% të vlerës së qirasë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, për muajin prill dhe maj. Për këtë masë janë të ndara 12.000.000.00 EUR (dymbëdhjetë milion euro).
  iii. Mbulimi i vlerës së kontributeve pensionale për pagat lidhur me masat e parapara me këtë vendim për muajin prill dhe maj. Për këtë masë janë të ndara 8.000.000.00 EUR (tetë milion euro).

- Sigurimi i huadhënies pa interes për ndërmarrjet publike që kanë vështirësi financiare për shkak të situatës së emergjencës së shëndetit publik, me qëllim të sigurimit të likuiditetit të përkohshëm të tyre, me kthim deri më 31.12.2020. Për këtë masë janë të ndara 20.000.000.00 EUR (Njëzet milion euro).
- Sigurimi i mbështetjes shtesë financiare për komunat e Republikës së Kosovës, që janë ndikuar në përballje me pandeminë, në rast nevoje për shkak të zgjatjes eventuale të situatës së emergjencës së shëndetit publik, në vlerë deri në 10.000.000.00 EUR (dhjetë milion euro).
- Sigurimi i shtesës mbi pagë në vlerë prej 300 EUR (treqind eurosh) për punëtorët në terren dhe që janë të ekspozuar drejtpërdrejt rrezikut të infektimit në punën e tyre (jo i gjithë stafi i institucionit); Stafi mjekësor (mjekët dhe infermierët), policët e Policisë së Kosovës, zyrtarët (gardianët) e Shërbimit Korrektues zyrtarët (zjarrfikësit) e Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave, personeli (ushtarët) e FSK-së, punëtorët që punojnë në karantinë- Qendra e Studentëve të Prishtinës, zyrtarët (inspektorët) e Inspektoratit të Punës, zyrtarët (inspektorët) e Administratës Tatimore të Kosovës, zyrtarët (doganierët) e Doganës së Kosovës, zyrtarët (Inspektorët) e Inspektoratit të Tregut, zyrtarët (inspektorët) e inspektorateve përkatës komunal, zyrtarët e inspektoratit të Mjekësisë së Punës për muajin prill. Për këtë masë janë të ndara 15.000.000.00 EUR (pesëmbëdhjetë milion euro).
- Pagesë shtesë në vlerën prej 100 EUR (njëqind euro) do ipen për punëtorët e dyqaneve ushqimore, furrave dhe farmacive për muajin prill dhe maj. Për këtë masë janë të ndara 3.000.000.00 EUR (tre milion euro).
- Pagesa e asistencës mujore në vlerë prej 130 EUR (njëqind e tridhjetë euro) për qytetarët që humbin vendin e tyre të punës për arsye të situatës së emergjencës së shëndetit publik, për muajt prill, maj dhe qershor. Për këtë masë janë të ndara 4.000.000.00 EUR (katër milion euro).
- Mbështetja e iniciativave dhe projekteve që synojnë përmirësimin e jetës së komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovë që janë goditur më rëndë nga situata e emergjencës publike. Për këtë masë janë të ndara 2.000.000.00 EUR (dy milion euro).
- Sigurim i likuiditetit financiar për:
    i. Mikro-ndërmarrjet dhe të vetë-punësuarit nëpërmjet pro grameve të caktuara të Fondit për Garantimin Kreditor të Kosovës, në shumën prej 10.000.00 EUR (dhjetë mijë euro) për një periudhë prej 24 muajsh. Për këtë masë janë të ndara 15.000.000.00 (pesëmbëdhjetë milion euro).

ii. Shoqëritë Tregtare/Kompanitë të autorizuara që ofrojnë shërbime bazike (të ngjashme me ndërmarrjet publike) me kthim deri më 31.12.2020, në kuadër të vlerës prej 20.000.000.00 EUR (njëzet milion euro) tek Sigurimi i huadhënies pa interes për ndërmarrjet publike.

- Rritja e buxhetit për grante dhe subvencione për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit rural për rritje të prodhimit bujqësor, në vlerë prej 5.000.000.00 EUR(pesë milion euro).
- Rritja e buxhetit për grante dhe subvencione për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për evitimin e situatës së krijuar nga emergjenca e shëndetit publik në aktivitetet sportive dhe kulturore, në vlerë prej 5.000.000.00 EUR (pesë milion euro).
- Mbështetje për eksportuesit në Republikën e Kosovës pas përfundimit të situatës së emergjencës së shëndetit publik, në vlerë prej 10.000.000.00 (dhjetë milion euro).
- Mbështetje financiare për shoqëritë tregtare që regjistrojnë punëtorët me kontratë pune, së paku 1 (një) vjeçare gjatë periudhë së emergjencës së shëndetit publik, nga 130 EUR (njëqind e tridhjetë euro) për dy muajt pasues pas regjistrimit. Për këtë masë janë të ndara 6.000.000.00 EUR (gjashtë milion euro).
- Pagesa e asistencës mujore në vlerë prej 130 EUR (njëqind e tridhjetë euro) për qytetarët me kushte të rënda sociale, të lajmëruar si të papunë në institucionin kompetent, që nuk janë përfitues të asnjë të hyre mujore nga buxheti i Kosovës, për muajt prill, maj dhe qershor. Për këtë masë janë të ndara 3.000.000.00 (tre milion euro);

Është autorizuar Ministri i Financave dhe Transfereve që për masat e nevojshme të parapara në Pakon Emergjente Fiskale të nxjerr vendim për të përcaktuar kriteret afatet, kushtet, mënyrën e zbatimit si dhe të gjitha specifikat e tjera të nevojshme për zbatimin e tyre, sipas parimeve të menaxhimit të financave publike.

Ky dokument bëhet vetëm për qëllime informative. Nuk përbën këshillë ligjore dhe/ose angazhim të çdo lloj natyre. Për çdo sqarim ju lutem kontaktoni:
**tax_legal-alko@deloittece.com**